

Nr. Prot. 040/B/18**VENDIMI Nr. 1231****Për****‘Rezervimin e blloqeve numerike Jo-Gjeografike (mobil) nga seritë****(0)43 xxx xxx dhe (0)49 xxx xxx****për përdorim nga Operatori “IPKO Telecommunications” LLC**

Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 3), nenit 47, paragrafi 9), nenit 58, nenit 59, paragrafi 1) dhe neni 79, paragrafi 1) dhe 2) i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*); nenit 4 paragrafi 2.c) dhe paragrafi 4.5), nenit 6), nenit 8) dhe nenin 16) të Rregullores Nr. 32 për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës (*Ref. Nr. Prot. 038/B/17, tutje referuar si - Plani i Numeracionit*); në bazë të kërkesës së operatorit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, IPKO Telecommunications LLC (*tutje referuar si - IPKO*) të datës: 08/05/2018 (*Ref.Nr.Prot.414/2/18*) dhe nenit 11 paragrafi 3.3) dhe paragrafi 3.18) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i Autoritetit në përbërje prej:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi | Kryetar |
| 2) z. Bahri Anadolli | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari | Anëtar |
| 4) z. Nijazi Ademaj | Anëtar |

në mbledhjen e 29-të me radhë të mbajtur më datë 22 Qershor 2018, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, rekomandimit të paraqitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamentit Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e operatorit **IPKO** për rezervimin e blloqeve numerike jo-gjeografike mobile të specifikuara si më poshtë:

| Prefiksi (NDC) | Fillimi i Bllokut | Fundi i Bllokut | Madhësia e Bllokut |
|------------------|-------------------|-----------------|--------------------|
| (0)43 | 100 000 | 199 999 | 100,000 |
| (0)49 | 000 000 | 099 999 | 100,000 |
| Gjithsej; | | | 200,000 |

- II. Tarifimi për blloqet numerike të rezervuara në pikën I) të këtij vendimi do të bëhet në bazë të nenit 8 të Planit të Numeracionit.
- III. Rezervimi i blloqeve numerike të specifikuara në pikën I) të këtij vendimi vlenë për periudhën dy (2) vjeçare nga data e nënshkrimit të vendimit.
- IV. Fillimi i përdorimit të resurseve të rezervuara në pikën I) të këtij vendimi duhet të caktohet me vendim të veçantë të ARKEP, pas kërkesës me shkrim të IPKO për përdorim të këtyre resurseve.
- V. Rezervimi mund të ndërpritet nga IPKO, përmes një kërkesë me shkrim të dorëzuar në zyret e ARKEP.
- VI. Rezervimi do të ndërpritet nga ARKEP, në rast se identifikohet përdorimi i së paku një numri të rezervuar pa miratimin paraprak me shkrim nga ARKEP.
- VII. ARKEP rezervon të drejtën që në të ardhmen të ndryshojë këtë vendim, nëse e shihet të arsyeshme, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe për çdo ndryshim në lidhje me vendimin, me kohë do të informojë palët e interesit.
- VIII. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 59, paragrafi 1) përkufizon se numrat, seritë numerike, mund të përdoren vetëm në bazë të vendimit të Autoritetit. Rrjedhimisht asnjë ndërmarrës i përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, operator dhe/apo ofrues i shërbimit universal, ose shfrytëzues tjerë nuk mund të përdorë një numër-at apo blloqet/seritë numerike përveç nëse dhe derisa ARKEP t'i caktojë (akordojë) apo vazhdojë autorizimin për përdorimin e numrave të tillë.

Në bazë të nenit 47, paragrafi 9), Autoriteti mund të rezervojë resurse specifike të komunikimeve elektronike për të siguruar zhvillim adekuat të rrjeteve dhe/ose shërbimeve dhe teknologjive të komunikimeve elektronike.

Në bazë të Planit të Numeracionit, neni 16, seria 4x e numrave është e përcaktuar si seri e numeracionit jo-gjeografik **për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.**

Neni 6, paragrafi 6) i Planit të Numeracionit përcakton se rezervimi i numrave mund të bëhet për një periudhë deri në dy (2) vite. Po ashtu neni 8.1.2 i Planit të Numeracionit specifikon se tarifa vjetore për rezervim është 70% e tarifave për caktim të specifikuara në paragrafin 8.1.1) të Planit të Numeracionit.

Andaj, me qëllim të;

- Sigurimit të strukturimit dhe shfrytëzimit efikas të numrave dhe serive të numrave;

- Përbushjes së nevojave të arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave;
- Sigurimin që caktimi dhe përdorimi i numrave/serive numerike bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jo-diskriminuese; dhe
- Zhvillimit adekuat të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Atëherë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 05/ 07/ 2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet;

- IPKO Telecommunications LLC.
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP
- Departamentit Ligjor, ARKEP dhe
- Arkivit